

Thirrje për aplikim për pozicion të lirë pune

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, institucion institucion qëndror në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve. Në zbatim të funksionit për kontrollin e cilësisë së shërbimit të punës së Strukturave për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel vendor, Agjencia në bashkëpunim me UNICEF do të hartojë dokumentin “Kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve”, siç parashikohet në Agjendën e re për të Drejtat e Fëmijës. 2021 – 2026.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të projektit të përbashkët me UNICEF për hartimin e dokumentit “Kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve”, shpall procedurën për pranimin në vendin e lirë të punës, për periudhën 6 mujore, sipas pozicioni të mëposhtëm:

1. **(Një) specialist, në sektorin e mbrojtjes dhe montorimit të të drejtave të fëmijëve, në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, kategoria IV-a.**

Përshkrimi i punës

Specialisti duhet të asistojë dhe mbështetë ekspertet e kontraktuar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe UNICEF lidhur me detyrat si më poshtë vijon:

1. Të ndihmojë në analizën e kuadrit ligjor aktual lidhur me punën e NJMF
2. Të zhvillojë intervista me persona kyc për të vlerësuar situatën aktuale
3. Të ndihmojë gjatë pilotimit të dokumentit në disa bashki, përpara dorëzimit të dokumentit final

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të kenë mbaruar Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Punë Sociale ose profile të ngjashme.
2. Niveli i diplomës: master shkencor.
3. Preferohet të ketë eksperiencë në fusha të cilat janë të lidhura me fëmijët
4. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze
5. Të ketë njohuri për kuadrin ligjor mbi mbrojtjen e fëmijëve.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerzore të Institucionit, në rrugë postare brenda datës 12.12.2021 dokumentat si më poshtë vijon:

- a) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listës së notave;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Curriculum vitae
- d) Letër motivimi
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- f) Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsim shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në CV tuaj;

Aplikimet pranohen deri ne daten 26 nentor 2021.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Rruga e Durrësit Nr 83, Tiranë